

Mbrojtja e Thaçit dhe Krasniqit s'kanë më prova e dëshmitarë, gjykimi drejt fundit



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE DËNON VENDIMIN PËR MOSCERTIFIKIMIN E LISTËS SERBE PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT



Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në Kosovë për të mos e certifikuar Listën Serbe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë ka theksuar se përpjekjet e Lëvizjes Vetëvendosje për ta bllokuar certifikimin e Listës Serbe “janë shkurtpamëse dhe përcarëse”

VENGU:
ANËTARËSIMI I
KOSOVËS NË
KARTËN E
ADRIATIKUT, NEVOJË
STRATEGJIKE F. 3



**KOSOVA
DHE BOSNJA
FLASIN PËR
BASHKËPUNIM
USHTARAK F. 7**



AKTUALE



**BE-ja I BËN THIRRJE KPK-së
TA ZBATOJË PLOTËSISHT
REFORMËN F. 3**

**PRESIDENTJA OSMANI DEKORON
AKTIVISTËT PËR TË DREJTAT E
PERSONAVE ME NEVOJA TË
VEÇANTA NË DITËN BOTËRORE
TË TYRE F. 5**

**RIFAT LATIFI ZGJIDHET DREJTOR
I QKSTK-së NË UNIVERSITETIN
E PRISHTINËS F. 7**

**POLICIA THEKSON VENDOSMËRINË
QË TA LUFTOJË DHUNËN NË
FAMILJE DHE TA SIGUROJË
MBROJTJEN DHE SIGURINË
E ÇDO QYTETARI F. 6**

EKONOMI



**DËSHIMI I "ELEKTROSEVER"-it
NË VERI KUSHTON 42 MILIONË
EURO, BE-ja REFUZON
KOMPENSIMIN NDAJ KOSOVËS F. 8**

RRITEN TË HYRAT E QEVERISË F. 8

SPORT

**EKIPET E SUPERLIGËS KALOJNË
RRETHIN E PARË TË KUPËS
SË KOSOVËS F. 11**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NË KOMISIONIN E DHOMËS SË PËRFAQËSUESVE, ADMINISTRATËS TRUMP I KËRKOHET TË ANGAZHOHET MË SHUMË NË BALLKAN

UASHINGTON, 3 DHJETOR - Pjesëmarrës në diskutimet në Komitetin për Politikë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara i kanë bërë thirrje administratës së presidentit Donald Trump të angazhohet më shumë në Ballkanin Perëndimor për ta stabilizuar rajonin, duke vlerësuar se Rusia, përmes Serbisë, është faktori kryesor për destabilizim. Duke hapur seancën dëgjimore të martën vonë, kryetari republikan i Nënkomitetit për Evropën, Keith Self, vlerësoi se Ballkani Perëndimor, përveç Ukrainës që është nën pushtimin rus, është “rajoni më i paqëndrueshëm në Evropë”. Marrëdhëniet e pazgjidhura të Serbisë me Kosovën janë një nga nxitësit kryesorë të paqëndrueshmërisë rajonale, çka më tej i mundëson Rusisë ta minojë Bashkimin Evropian dhe aftësinë e NATO-s për t’i fuqizuar vendet e Ballkanit, tha Self. Përkeqësimi i situatës në Bosnjë-Hercegovinë ka çuar, sipas tij, në “rritje të madhe të përdorimit të kompetencave juridikisht të diskutueshme” të përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar. Në rast konflikti, aleatët e NATO-s - Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi - do të jenë drejtpërdrejt në shënjestër, gjë që mund të çojë në aktivizimin potencial të nenit 5 të Aleancës, tha Self, duke shtuar se aleatët e NATO-s në Ballkan duhet të ndërtojnë së bashku pengesë politike dhe ushtarake, por se Kosova do të jetë veçanërisht e ekspozuar për shkak se nuk është pjesë e aleancës perëndimore. Kundërshtarët e ShBA-së po i



shfrytëzojnë aktivisht dobësitë për të zhvilluar luftë hibride që rrit paqëndrueshmërinë në rajon, tha Self, duke nënvizuar se Kina po e përdor ndikimin e saj duke kryer stërvitje ushtarake dhe duke dërguar armë në Serbi. Përveç kësaj, shtoi ai, Kina po nënshkruan marrëveshje ekonomike në të gjithë rajonin me synimin e ruajtjes së aparatit të saj keqdashës dhe shfrytëzimit të korrupsionit në Ballkanin Perëndimor. Rusia, gjithashtu, ndikon në rritjen e tensioneve në Bosnjë, në Republikën Serpska dhe në Serbi, theksoi Self, duke vënë në pah se ish-presidenti i entitetit serb në Bosnjë, Millorad Dodik, po vazhdon ta përdorë kapitalin politik për ta kontrolluar Republikën Serpska dhe për të vepruar në interes të Rusisë duke kërcënuar me ndarjen e saj nga Bosnja. Nga ana tjetër, sipas tij, Serbia, pavarësisht dërgimit indirekt të armëve në Ukrainë, ka gjithashtu lidhje mbrojtëse me Rusinë dhe Kinën dhe promovon propagandën kineze dhe ruse. Ai vuri në dukje se për ta përfunduar ndikimin politik të Moskës, duhet trajtuar çështja e varësisë së Serbisë nga

energja ruse. Pavarësisht prej këtyre sfidave, ende ekzistojnë mundësi për përmirësimin e stabilitetit, paqes dhe prosperitetit në Ballkanin Perëndimor, dhe lidërsihipi amerikan duhet të ketë rol të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit dhe parandalimin e rikthimit të konflikteve, tha Self, duke përsëritur administratën Trump për riangazhimin në këtë, siç e quajti ai, “rajon shpesh të neglizhuar”. William R. Keating, anëtari me rang më të lartë demokrat në Nënkomitet, shprehu bindjen se ShBA-ja duhet të vazhdojë ta mbështesë të ardhmen e Bosnjës, përfshirë Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë (OHR). Ai kritikoi administratën Trump për heqjen e sanksioneve ndaj Dodikut dhe bashkëpunëtorëve të tij, të cilët, siç tha ai, kanë treguar pak gatishmëri për ta ndryshuar sjelljen në Republikën Serpska. Duke theksuar se presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, për vite ka minuar sundimin e ligjit dhe ka forcuar lidhjet e Serbisë me Kinën dhe Rusinë, ai i bëri thirrje sekretarit të Shtetit, Marco Rubio, ta forcojë luftën kundër korrupsionit dhe

sundimit të ligjit në Serbi, si dhe t’i bëjë të qartë Beogradit se forcimi i lidhjeve me Moskën dhe Pekinin nuk është i përputhshëm me synimin e deklaruar për t’u integruar në komunitetin transatlantik. Ai u shpreh i bindur se një angazhim më i madh amerikan në Ballkan do ta afronte rajonin me anëtarësimin në BE dhe i bëri thirrje administratës Trump t’i sigurojë aleatët dhe partnerët në rajon se ShBA do të vazhdojë të jetë e angazhuar dhe e përkushtuar ndaj së ardhmes së tij. Max Primorac, hulumtues në Qendrën për Liri Margaret Thatcher pranë Fondacionit konservator Heritage, vlerësoi se “Ballkani nuk është në gjendje të mirë” dhe shtoi se “Bosnja është një shtet i dështuar” 30 vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes së Dejtonit për paqe dhe miliardave të shpenzuara në ndihmë nga ShBA-ja. Ai tha se Bosnja është “në krizë të përhershme” dhe se është koha të përfundojë “dështimi katastrofik i ndërtimit të shtetit”, duke theksuar se sovraniteti i vendit duhet të rivendoset duke mbyllur Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë “që shkarkon liderë të zgjedhur, vendos veto mbi ligjet dhe ndalon këdo që nuk i pëlqen”. Gazi dhe nafta amerikane mund të ndihmojnë në ndërprerjen e varësisë së Ballkanit nga Rusia, në heqjen e fondeve për makinerinë e luftës së Vladimir Putinit dhe në minimizimin e ndërhyrjes së Moskës në rajon, tha Primorac, duke vlerësuar se qeveria amerikane kishte të drejtë të vendoste sanksione ndaj NIS për shkak të pronësisë ruse. “Shtëpia e Bardhë duhet të

caktojë ambasadorë politikë në Ballkan për të promovuar një agjendë të fokusuar në biznes, por të jetë e gatshme të përdorë viza, sanksione bankare dhe të tjera, si dhe stimuj tregtarë e investues për ta nxjerrë rajonin nga duart ruse, kineze dhe iraniane”, tha ai. Luke Coffey, hulumtues në Qendrën për Evropën dhe Euroazinë në Institutin Hudson, tha se Rusia e sheh Ballkanin si zonë për shkaktim të destabilitetit dhe për përçarjen e aleancës transatlantike, ndërsa Serbia mbetet ndihmës i Rusisë dhe shërben si bazë kryesore ruse në rajon. “Ndërsa Serbia herë pas here pretendon një qasje të balancuar të politikës së jashtme, realiteti është se Beogradi është i ankoruar thellë në orbitën ruse dhe kjo nuk do të ndryshojë së shpejti”, tha Coffey. Ai shtoi se Kremli përdor Republikën Serpska për të përhapur më tej paqëndrueshmëri, duke theksuar se Dodik, edhe pse është shkarkuar nga funksioni, mbetet me ndikim dhe vazhdon të avokojë për shkëputje, gjë që është mbështetur prej vitesh nga Rusia dhe Serbia. Ai gjithashtu kritikoi heqjen e sanksioneve ndaj Dodikut dhe bashkëpunëtorëve të tij. Coffey vlerësoi se Marrëveshja e Dejtonit është një nga sukseset më të mëdha të politikës së jashtme amerikane pas Luftës së Ftohtë dhe se zhbërja e saj do të krijonte paqëndrueshmëri të mëtejshme. “Edhe pse ShBA nuk është vend ballkanik, ajo mund të jetë fuqi ballkanike, dhe presidenti Trump duhet të marrë hapa për të siguruar mbrojtjen e interesave kombëtare amerikane atje”, tha Coffey.

NGRIHET AKTAKUZË KUNDËR MOGHERINIT PËR MASHTRIM DHE KORRUPSION

BRUKSEL, 3 DHJETOR - Zyra e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) njoftoi të mërkurën se ka ngritur aktakuzë kundër ish-shëfës së politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, dhe dy persona të tjerë, për mashtrim në prokurime dhe për korrupsion, si dhe për konflikt interesi dhe shkelje të sekretit profesional. Ata u arrestuan të martën si pjesë e një hetimi të BE-së për mashtrim, por u liruan më vonë derisa hetimet të vazhdojnë, tha EPPO-ja, duke shtuar se nuk ka rrezik që ata të ikin. EPPO-ja i përshkroi dy të

dysshuarit e tjerë si një punonjës të lartë të College of Europe në Bruzh dhe një zyrtar të lartë të Komisionit Evropian. Tri burime i thanë agjencisë së lajmeve “Reuters” se një nga të ndaluarit ishte diplomatik i lartë i BE-së, Stefano Sannino. “Të gjitha personat konsiderohen të pafajshëm derisa fajësia të provohet nga gjykatat kompetente belge”, shtoi EPPO. Ata u arrestuan pas bastisjeve në shërbimin diplomatik të BE-së në Bruksel, në College of Europe - një universitet elitar në Bruzh që arsimon shumë zyrtarë të BE-së - si dhe në



shtëpitë e të dysshuarve. Mogherini ka qenë përfaqësuese e lartë e BE-së për politikën e jashtme dhe të sigurisë dhe drejtoreshë e

shërbimit diplomatik nga 2014 deri në 2019. Ajo u bë rektore e College of Europe në vitin 2020. Mogherini ishte përfaqësuese e lartë për punët e jashtme nga

viti 2014 deri në vitin 2019. Ajo u emërua drejtoreshë e kolegjit pasuniversitar College of Europe më 2020. Mogherini e ka ndërmjetësuar për disa vjet dialogun midis Kosovës dhe Serbisë. Sipas EPPO-s, hetimi lidhet me “dyshime për mashtrim që ka të bëjë me trajnime të financuara nga BE për diplomatë të rinj”. Mogherini dhe Sannino, që të dy shtetas italianë, janë figura të njohura në qarqet diplomatike të Brukselit, dhe lajmi për arrestimin e tyre shkaktoi tronditje në komunitetin e BE-së të martën.

BE-ja i bën thirrje KPK-së ta zbatojë plotësisht reformën

Prishtinë, 3 dhjetor - Zyra e Bashkimit Evropian (BE) u ka bërë thirrje të gjithë anëtarëve që së bashku ta zbatojnë reformën në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK). Kjo thirrje është bërë në një takim që është zhvilluar me anëtarët e KPK-së. Nga kjo zyrë kanë thënë se sundimi i ligjit është

“parakusht thelbësor i BE-së”. “Në një takim me Këshillin Prokurorial të Kosovës, BE-ja në Kosovë u bëri thirrje sot të gjithë anëtarëve të saj që të zbatojnë së bashku dhe plotësisht reformën e KPK-së, të sigurojnë ligjshmërinë e vendimeve të tyre, të veprojnë me integritet dhe ta ruajnë besimin e publikut në

sistemin e drejtësisë”, ka thënë Zyra e BE-së në Kosovë. Ish-ministrja në detyrë, Albulena Haxhiu, ka akuzuar KPK-në për bllokim të reformës, duke e cilësuar të kapur. Edhe shoqëria civile ka akuzuar disa anëtarë të KPK-së që me veprimet e tyre po bllokojnë procesin e reformës.



MBROJTJA E THAÇIT DHE KRASNIQIT S'KANË MË PROVA E DËSHMITARË, GJYKIMI DREJT FUNDIT



HAGË, 3 DHJETOR - Gjykimi në rastin e krerëve të UÇK-së tashmë është në fazën e fundit. Edhe zyrtarisht mbrojtja e Hashim Thaçit dhe e Jakup Krasniqit e kanë njoftuar trupin gjykues në Speciale, se po i mbyllin çështjet e tyre. Pra, nuk ka më dëshmitarë e as prova. Në parashtrësat e publikuara specifikohet se më nuk ka asnjë dokument që do të paraqitet. “Në përputhje me urdhrin e trupit gjykues, mbrojtja e z. Hashim Thaçi konfirmon me anë të kësaj se, në këtë fazë, nuk ka më dëshmitarë për t'u thirrur dhe

asnjë material tjetër provues për t'u paraqitur si pjesë e çështjes së mbrojtjes. Rrjedhimisht, në përputhje me Rregullin 131 të Rregullores, mbrojtja e mbyll çështjen e saj. Megjithatë, ky njoftim nuk cenon asnjë ndihmë të përshtatshme që mbrojtja mund të kërkojë në lidhje me çështjet e provave që mbeten pezull para trupit gjykues”, është thënë në parashtrësë. Ngjashëm është thënë edhe në parashtrësën e mbrojtjes së Jakup Krasniqit. “Mbrojtja e Jakup Krasniqit nuk ka ndër mend të thërrasë më shumë

dëshmitarë ose të paraqesë ndonjë material tjetër provues si pjesë të çështjes së saj. Rrjedhimisht, në përputhje me Rregullin 131 të Rregullores, dhe urdhrin e trupit gjykues, mbrojtja e Krasniqit me anë të kësaj mbyll çështjen e saj. Ky njoftim nuk cenon asnjë ndihmë të përshtatshme që mbrojtja e Krasniqit mund të kërkojë në lidhje me çështjet e provave që mbeten pezull para trupit gjykues”, është thënë në parashtrësë. Deri te ky vendim vjen pas refuzimit të shtimit të Bislim Zyrapi në listën e

dëshmitarëve. Në seancën e fundit, mbrojtja e krerëve të UÇK-së dhe Prokuroria kanë kërkuar disa ndryshime në afatet që ishin dhënë paraprakisht nga gjyqtarët. Ato përfshinin afatet për dosjen përfundimtare, fjalën finale që do ta afektonte edhe dhënien e vendimit. Prokuroria dhe mbrojtja kanë kërkuar që të kenë kohë deri më 30 janar për dorëzimin e dosjeve përfundimtare, kurse 45 ditë pas kësaj, të jepen fjalët finale. Kjo i bie që deri në mesin e muajit mars të jepen fjalët përfundimtare.

Megjithatë, Gjykata Speciale nuk e ka aprovuar krejt kërkesën. Bazuar në vendimin e fundit, Gjykata Speciale ka vendosur që dosjet përfundimtare të dorëzohen deri më 19 janar, kurse fjalët finale të jepen prej 9 deri më 13 shkurt, gjithashtu më 16 dhe 18 shkurt. Si rezultat, pas dhënies së fjalëve përfundimtare, gjyqtarët kanë kohë të paktën tre muaj për dhënien e vendimit. Pra, vendimi në shkallën e parë për Thaçin e të tjerët pritet në fundin e muajit maj, më së largu deri në fillimin e qershorit.

Vengu: Anëtarësimi i Kosovës në Kartën e Adriatikut, nevojë strategjike

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në Kartën e Adriatikut është nevojë strategjike. Këto deklaratë ministri shqiptar i bëri në Ministerialin e Kartës së Adriatikut në Sarajevë, një forum që bashkon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

pesë vende të Ballkanit Perëndimor. Ai përmendi edhe sfidat e kërcënimit me të cilat përballat Ballkani Perëndimor. “Ballkani Perëndimor ka ende shumë sfida të trashëguara dhe kërcënime të reja, të cilat kërkojnë partneritet me të ngushtë, investime në kapitalin njerëzor, në mbrojtje kibernetike, në industri, në

pajisje dhe sisteme të përbashkëta. Me ShBA-në besojmë se kjo nismë rajonale është një platformë e domosdoshme, e cila duhet të orientohet drejt bashkëpunimit më efektiv në dobi të rritjes së qëndrueshmërisë së çdo vendi pjesëmarrës”, shkroi ai në “Facebook”.



KQZ-ja certifikon Nismën Socialdemokrate për zgjedhjet e 28 dhjetorit

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar të mërkurën Nismën Socialdemokrate për zgjedhjet

e 28 dhjetorit. Pro certifikimit të Nismës së Fatmir Limajt kanë votuar të gjithë anëtarët e KQZ-së.

Në mbledhje është thënë se Nisma ka plotësuar të gjitha kriteret për certifikim dhe se ka dorëzuar edhe listën e

nënshkrimeve që në mbledhjen e së martës i mungonte. Të martën KQZ-ja ka certifikuar

të gjitha subjektet politike që kanë aplikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, me përjashtim të Listës Serbe.



BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE DËNON VENDIMIN PËR MOSCERTIFIKIMIN E LISTËS SERBE PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në Kosovë për të mos e certifikuar Listën Serbe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë ka theksuar se përpjekjet e Lëvizjes Vetëvendosje për ta bllokuar certifikimin e Listës Serbe “janë shkurt-pamëse dhe përçarëse”

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në Kosovë për të mos e certifikuar Listën Serbe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. Kjo është hera e tretë që partia më e madhe e serbëve të Kosovës përballet me përpjekje për të mos ia lejuar pjesëmarrjen në zgjedhje qoftë parlamentare apo lokale këtë vit. Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë tha në “Facebook” të mërkurën se përpjekjet e Lëvizjes Vetëvendosje për ta bllokuar certifikimin e Listës Serbe “janë shkurt-pamëse dhe përçarëse”. Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë nënvizoi se “politizimi i KQZ-së nga Lëvizja Vetëvendosje dhe partitë e tjera politike është i dëmshëm për procesin zgjedhor gjithëpërfshirës”.

Ambasadori britanik në Kosovë, Jonathan Hargreaves, theksoi se ndihet “i shqetësuar” për përpjekjen e fundit nga aktorët politikë për të mos e lejuar Listën Serbe të marrë pjesë në proceset zgjedhore. “Veprime të tilla rrezikojnë ta minojnë reputacionin e fituar me vështirësi të Kosovës si një demokraci shumetnike dhe të dëmtojnë marrëdhëniet me partnerët e saj të ngushtë”, tha Hargreaves në “Facebook”. Ndërsa Ambasada e Gjermanisë shprehu “keqardhjen për sjelljen penguese të disa anëtarëve” të KQZ-së. “Procesi zgjedhor dhe përgatitjet teknike për zgjedhjet duhet të jenë të lira nga manovrimet politike të aktorëve politikë”, shkroi ajo në “Facebook”. Gjatë një mbledhjeje të martën pasdite, anëtarët e KQZ-së nuk e certifikuan Listën Serbe, e cila është partia më e madhe e

serbëve të Kosovës dhe, njëkohësisht, është e vetmja që e gëzon mbështetjen e Beogradit. Rekomandimi për certifikimin e saj i mori vetëm dy vota për, ndërsa dy anëtarë votuan kundër dhe shtatë abstenuan. Anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ, Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi, ishin të vetmit që votuan kundër. Kurteshi tha gjatë mbledhjes se “e kam thënë gjithmonë se kjo parti punon kundër interesave të Kosovës”. Anëtarët e partive të tjera politike shqiptare në KQZ, nga Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, abstenuan nga votimi. Kryetari i Listës Serbe, Zlatan Eleka, ka bërë me dije se kanë paraqitur ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për të mos certifikuar partinë e tij për zgjedhjet e ardhshme parlamentare të 28 dhjetorit. Ambasada Amerikane paralajmëroi gjithashtu se vendime të tilla do të ndikojnë në marrëdhëniet e ShBA-së me Kosovën, përfshirë Dialogun e pezulluar Strategjik. “Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të kenë mundësi t’i ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike. Veprime të tilla minojnë

stabilitetin e Kosovës dhe interesat e ShBA-së, duke përfshirë edhe rifillimin e dialogut tonë strategjik për t’i avancuar mundësitë për bizneset amerikane dhe kosovare”, tha ajo. ShBA-ja e pezulloi në shtator nisjen e Dialogut Strategjik, duke e arsyetuar këtë me veprimet e qeverisë së udhëhequr nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, të cilat, sipas saj, kanë “rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë”. Më herët, vendimi i komisionit u kritikua edhe nga Serbia dhe nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (OSBE), i cili tha se është “i zhgënjyer dhe i shqetësuar thellësisht”. OSBE-ja theksoi se është “seriozisht e shqetësuar për rritjen e polarizimit politik brenda KQZ-së, i cili reflektohet në sjelljen gjatë votimit që duket se udhëhiqet nga interesa partiake, e jo nga kriteret ligjore dhe parime demokratike”. “Sjellja e tillë minon paanshmërinë dhe besueshmërinë që janë thelbësore për një organ të pavarur të administrimit të zgjedhjeve”, tha ajo. Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Marko Gjuriq, e cilësoi “plotësisht të papranueshëm” vendimin e KQZ-së. “Kjo tregon jo vetëm mungesën e

kapaciteteve demokratike, por edhe një qëndrim plotësisht të papranueshëm ndaj një tërë komuniteti kombëtar”, tha Gjuriq në Uashington në një bisedë me gazetarë nga Serbia. Kreu i diplomacisë së Serbisë shtoi, me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, ky vendim do të rishikohet ashtu si në zgjedhjet e mëparshme. Kjo është hera e tretë që KQZ-ja nuk e certifikon fillimisht këtë parti, pasi ngjashëm veproi edhe për zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit dhe për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Në të dy rastet e mëhershme PZAP-ja ia kishte rrëzuar vendimin e KQZ-së. Në zgjedhjet e 9 shkurtit Lista Serbe i fitoi 9 prej 10 ulëseve të garantuara për pakicën serbe në Kuvendin e Kosovës, ndërsa ajo i fitoi të gjitha 10 komunat me shumicë serbe në zgjedhjet lokale të tetorit, duke u rikthyer në pushtet pasi i kishte braktisur institucionet e Kosovës më 2022. Kosova do të mbajë zgjedhje të parakohshme këtë muaj sepse partia në pushtet e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, Lëvizja Vetëvendosje, nuk arriti në dy përpjekje ta marrë mbështetjen e Kuvendit për një mandat të ri. Ajo i fitoi zgjedhjet e 9 shkurtit, por 48 ulëse në Kuvend ishin të pamjaftueshme për të qeverisur e vetme dhe ajo nuk gjeti një partner për të formuar qoftë

PRESIDENTJA OSMANI DEKORON AKTIVISTËT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË DITËN BOTËRORE TË TYRE

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë vendim që t'i dekorojë me Medaljen Presidenciale të Meritave një grup aktivistësh të cilët, me angazhimin e tyre të palodhshëm, kanë kontribuar

në mënyrë të jashtëzakonshme për fuqizimin, mbrojtjen e të drejtave dhe përfshirjen dinjitoze të kësaj kategorie në shoqërinë tonë. Të dekoruarit e sivjetshëm janë: Halit Ferizi (postmortem), Agim Vatovci (postmortem), Sabrije Zeqa (postmortem), Merita Voca

(postmortem), Mexhid Foniqi (postmortem) dhe Hiljminijeta Apuk. Këta aktivistë, me avokimin e tyre publik, punën në terren dhe mbrojtjen e vazhdueshme të të drejtave të personave me nevoja të veçanta, kanë ndikuar në rritjen e vetëdijes shoqërore, avancimin e

politikave publike dhe gjithëpërfshirjen. Kontributi i tyre është shembull i përkushtimit qytetar dhe i vlerave, të cilat vazhdimisht i afirmojnë presidentja Osmani. Medaljet e akorduara do të dorëzohen në ceremoninë e veçantë të ndarjes së dekoratave që do të mbahet në

fund të muajit dhjetor 2025. Presidentja Osmani ka theksuar se shoqëria jonë bëhet më e drejtë dhe më e fortë nëpërmjet atyre që punojnë çdo ditë për barazi, dinjitet dhe përfshirje dhe se vlerësimi i tyre është një obligim institucional dhe moral.



Zëvendësministria Gashi: Kosova u paraqit partnere e qëndrueshme në Dhomën e Përfaqësuesve të ShBA-së

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Zëvendësministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, ka thënë se të martën në Dhomën e Përfaqësuesve të ShBA-së, Kosova u paraqit partnere e qëndrueshme, demokratike dhe plotësisht i përkushtuar ndaj vlerave perëndimore. Sipas saj, kongresistë dhe ekspertë nënvizuan se njohja e plotë e sovranitetit të Kosovës mbetet thelbësore

për stabilitetin rajonal, duke theksuar njëkohësisht nevojën për mbështetje të shtuar në fushën e sigurisë, forcimin e FSK-së dhe avancimin e kursit të Kosovës drejt integritetit në NATO. “Po ashtu, u kërkuar një qasje e balancuar në procesin e dialogut, që redukton tensionet dhe forcon paqen afatgjatë. Kosova u veçua për përkushtimin e saj ndaj demokratizimit, mbrojtjes së

të drejtave të pakicave dhe harmonizimit të qëndrueshëm me aleatët perëndimorë. Ndërkohë, u ngritën shqetësime serioze për trajtimin e shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe u prezantua një rezolutë që kërkon mbrojtjen e të drejtave të tyre. Është koha që Serbia të mbahet përgjegjëse për politikat diskriminuese ndaj shqiptarëve në këtë rajon”, ka thënë Gashi.



edhe një qeveri të pakicës prej 61 ulësesh në Kuvend.

Refuzimi i certifikimit të Listës Serbe, Cakolli e Krasniqi: Integriteti i KQZ-së po rrezikohet nga veprimet e disa anëtarëve

Analistët dhe njohësit e procesit zgjedhor kanë reaguar pas zhvillimeve të fundit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ku nuk u

certifikua Lista Serbe, duke theksuar se disa anëtarë po e dëmtojnë integritetin e institucionit dhe besimin publik në zgjedhje. Eugen Cakolli nga KDI-ja vlerëson se disa çështje janë të sajura për të nxjerrë në pah aktorë institucionalë. “Mos me qenë çështjet e sajura si ‘certifikimi i Listës Serbe’ dhe ‘votimi i diasporës’, disa akterë institucionalë as nuk do të vëreheshin nga publiku dhe as nuk do të kishin ndonjë peshë politike. Sepse roli i tyre politik varet krejt prej këtyre dramave të

sajura - ku zakonisht nis e mbaron i gjithë ‘kontributi’ i tyre”, ka shkruar Cakolli në “Facebook”. Ai ka shtuar se disa e kanë kthyer shpikjen e krizave në metodë pune për konsum politik. “Përndryshe, s’mbijetojnë dot politikisht”, shkruan Cakolli. Edhe Albert Krasniqi nga Demokracia Plus ka theksuar se anëtarët e KQZ-së betohen se do t'i kryejnë detyrat me ndershmëri, paanshmëri dhe profesionalizëm, derisa ka përmendur edhe përgjegjësinë ligjore që kanë.

“Anëtarët e KQZ-së betohen se do t'i kryejnë detyrat me ndershmëri, paanshmëri dhe profesionalizëm. Ligji parasheh se mandati i një anëtarit mund të ndërpritet kur sjelljet apo veprimet e tij e dëmtojnë seriozisht statusin dhe integritetin e Komisionit. Një vendim i tillë merret me shumicën prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të KQZ-së. Dy anëtarët e emëruar nga LV-ja kanë shfaqur sjellje që ose tregojnë mosnjohje elementare të ligjeve, ose synim të ndërgjegjshëm për ta dëmtuar procesin zgjedhor.

Këta dy anëtarë po i shkaktajnë dëm të drejtpërdrejtë integritetit të KQZ-së dhe besimit publik në procesin zgjedhor”, tha ai. Krasniqi shton se anëtarët e tjerë të KQZ-së duhet të tregojnë guxim dhe t'i qëndrojnë pas betimit për profesionalizëm dhe paanshmëri, duke mbrojtur kështu integritetin e procesit zgjedhor. Ndryshe, me 2 vota për, dy kundër dhe 7 abstenime, KQZ ka refuzuar certifikimin e Listës Serbe për zgjedhjet e 28 dhjetorit.

Theksohet rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet sektorit publik dhe atij privat

PEJË, 3 DHJETOR - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Zef Dedaj, mori pjesë në Forumin Ekonomik Rajonal - Dukagjini, i cili u organizua nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, me temën "Partneriteti i

institucioneve në funksion të ndërtimit të Heliksit të trefishtë". Gjatë këtij forumi Dedaj paraqiti aktivitetet kryesore të KIESA-s, duke theksuar rolin e agjencisë në mbështetjen e bizneseve vendore dhe zhvillimin e një klime të favorshme për investime të qëndrueshme. Ai nënvizoi rëndësinë e

bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe institucioneve akademike, si një model i domosdoshëm për krijimin e inovacionit dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Po ashtu, Dedaj theksoi angazhimin e MINT/KIESA-s në ofrimin e skemave mbështetëse

për ndërmarrjet, me qëllim të fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre. Në këtë ngjarje morën pjesë edhe ministrja në detyrë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, rektori i Universitetit "Haxhi Zeka", Armand Krasniqi, përfaqësues të institucioneve të



Kosovës, universiteteve nga rajoni, ekspertë të arsimit si dhe profesorë dhe studentë.

POLICIA THEKSON VENDOSMËRINË QË TA LUFTOJË DHUNËN NË FAMILJE DHE TA SIGUROJË MBROJTJEN DHE SIGURINË E ÇDO QYTETARI

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

Prishtinë, 3 dhjetor - Policia e Kosovës, Drejtoria për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prizren, ka organizuar një tryezë diskutimi në kuadër të fushatës globale "16 ditë të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore", me temën "Qasja në drejtësi për viktimat e dhunës në familje, me fokus në aspektet e sigurisë". Ky aktivitet ka mbledhur përfaqësues të institucioneve kyçe

të zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes së viktimave, përfshirë Prokurorinë e Shtetit, Zyrën për Mbrojtjen e Viktimave, qendrat për punë sociale, gjykatat, strehimoret, mekanizmat lokalë koordinues si dhe organizata të shoqërisë civile. Tryeza ka mundësuar një diskutim të hapur dhe shkëmbim të përvojave profesionale ndërmjet institucioneve relevante lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, zbatimin e masave mbrojtëse dhe forcimin e qasjes në drejtësi për viktimat. Diskutimet kontribuan në thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe forcimin e mekanizmave të koordinimit me komunitetin, me synim adresimin sa më efektiv të rasteve të dhunës në familje.



Një theks i veçantë iu kushtua garantimit të sigurisë së viktimave, përmes monitorimit elektronik të urdhrave mbrojtës dhe zbatimit të Procedurave Standarde Operative të Policisë që lidhen me reagimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rasteve. Policia e Kosovës riafirmoi

përkushtimin e saj për garantimin e një reagimi profesional, të koordinuar dhe të orientuar kah viktimat. Përmes trajnimeve të vazhdueshme, ngritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha institucionet partnere, Policia e

Kosovës mbetet e vendosur të luftojë dhunën në familje dhe ta sigurojë mbrojtjen dhe sigurinë e çdo qytetari. Policia e Kosovës falënderon OSBE-në për mbështetjen e vazhdueshme si dhe të gjitha institucionet pjesëmarrëse për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre të çmuar. Duke theksuar se dhuna në familje është e papranueshme dhe përbën vepër penale, Policia e Kosovës u bënë thirrje qytetarëve të raportojnë çdo rast të dhunës, duke siguruar se çdo raportim trajtohet me profesionalizëm, konfidencialitet dhe seriozitet të lartë, me qëllim mbrojtjen e menjëhershme të viktimave dhe parandalimin e çdo forme të dhunës.

KONSTITUOHET KUVENDI I KOMUNËS SË KAMENICËS, KADRI RAHIMAJ BETOHET KRYETAR

KAMENICË, 3 DHJETOR - Kuvendi i komunës së Kamenicës ka mbajtur të mërkurën mbledhjen inauguruese përmes së cilës u konstitua si organi më i lartë i qeverisjes lokale, i dalë nga zgjedhjet lokale të mbajtura më 12 tetor. Me këtë mbledhje nisi zyrtarisht puna e legjislaturës së tetë. Mbledhja u drejtua nga anëtari më i vjetër i Kuvendit, Sejdi Kurteshi, i cili mbajti fjalën e hapjes ku u verifikuan mandatet e të zgjedhurve si dhe udhëhoqi procesin e betimit. Gjatë ceremonisë të gjithë asamblistët njëzëri dhanë betimin solemn, duke shqiptuar fjalët: "Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime, me



ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltare e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë". Pas betimit të asamblistëve,

betimin e dha edhe kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, i cili solemnisht deklaroi: "Unë, Kadri Rahimaj, 'Betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Kamenicës, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë".

Kryetari Rahimaj në fjalën e tij tha se që sot po fillojnë një bashkëpunim i ri institucional i cili rrjedhë nga një besim shumë i madh dhe i rëndësishëm qytetar. "Nga ky besim po fillon kjo seancë e mbi të cilin besim edhe do të vazhdojë puna jonë e përbashkët në shërbim të

qytetarëve pa asnjë dallim. Rëndësia e angazhimit tonë është po aq e lartë dhe e rëndësishme sa vetë institucioni. Angazhimi ynë duhet të jetë në frymën që ta forcoj besimin e secilit qytetar në institucionet tona. Kjo është puna më e madhe që mund të bëjmë të gjithë bashkë. Kuvendi Komunal është vendi ku ne diskutojmë për çdo çështje për të cilën ne bashkë e shohim si interes për qytetin dhe qytetarin. Diskutimet ose debatet janë të mirëseardhura në çdo kohë dhe për çdo çështje që ndërlidhet me kompetencat e këtij organi të lartë vendimmarrës. Nga 27 asamblistë që ishim në mandatin e kaluar, sot Kuvendi Komunal i Komunës së Kamenicës ka 21 asamblistë nga 6 subjekte

politike. Ky pluralizëm politik është i domosdoshëm dhe shumë i nevojshëm për demokracinë. Ne zhvillohemi bashkë edhe atëherë kur ka më shumë se një mendim për një çështje të caktuar", ka thënë Rahimaj. Lëvizja Vetëvendosje ka 9 mandate, Partia Socialdemokrate e Kosovës (PSD) 4 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) 3 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) 3 mandate, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) 1 mandat dhe Lista Serbe (LS) 1 mandat. Konstituimi i Kuvendit shënon fillimin e punës së institucioneve të reja komunale dhe hap rrugën drejt ushtrimit të përgjegjësi të qeverisjes lokale për mandatin e ardhshëm katërvjeçar.

Ekstradohet i pandehuri nga Shqipëria për kultivim të 1 259 bimëve narkotike

Gjakovë, 3 dhjetor - Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka njoftuar se ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh ndaj të pandehurit me inicialet N. Sh.,

shtetas i Republikës së Shqipërisë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale, "Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës".

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera, ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet N. Sh., nga data e pavërtetuar deri më 19.06.2024, në fshatin Panorc, komuna Malishevë, në bashkëveprim me të pandehurin O. Sh., kanë kultivuar në tri (3) parcela me

rreth 1259 bimë, narkotik i llojit kanabis sativa në vendin e lartcekur, të cilat parcela janë identifikuar përmes vëzhgimit me dron nga ajri. I pandehuri ka qenë në arrati që nga koha e kryerjes së veprës penale. Ai është arrestuar me urdhërarrest ndërkombëtar dhe më pas është ekstraduar



nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës.

Gani Dreshaj i hyn garës për deputet

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Gani Dreshaj ka njoftuar se do të jetë kandidat për deputet në radhët e AAK-së. Ai ka treguar arsyen e kandidimit për zgjedhjet e 28 dhjetorit. “Dua të ndaj me ju disa nga arsyet pse kam vendosur të kandidohem në garën për deputet në zgjedhjet e 28 dhjetorit. Unë vij nga bota e

biznesit, por zemra ime ka qenë gjithmonë me njerëzit tanë, me familjet që kanë nevojë, me ata që punojnë çdo ditë për të ndërtuar shtet ligjor. Për mua politika ka kuptim vetëm kur kthehet në shërbim. Asnjëherë politikën s’e kam parë si një garë ku bëhet karrierë. Nëse mund të jem hajri i shpisë, mund të jemi

edhe kontribuesi i shoqërisë. Sigurisht që mërgata zë një vend të veçantë në zemrën time dhe janë gjithmonë pjesë e pandashme e imja duke qenë vet një shqiptar i rritur në grybet. Ju e dini një gjë nga unë, aty ku kam pasur fuqi të ndikoj, e realizoj. I tillë do të jem përherë”, ka shkruar Dreshaj në “Facebook”.



RIFAT LATIFI ZGJIDHET DREJTOR I QKSTK-së NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Profesor Rifat Latifi është zgjedhur drejtor i Qendrës për Kërkime, Simulime dhe Trajtime të Avancuara Kirurgjike dhe Mjekësore të Kosovës (QKSTK) në Universitetin e Prishtinës. Ai është, gjithashtu, themelues dhe president emeritus i Kolegjit të Kirurgëve të Kosovës dhe ideator i QKSTK-së. Qendra për Kërkime, Simulime dhe Trajtime të Avancuara Kirurgjike dhe Mjekësore të Kosovës në UP do të ofrojë mbështetje në edukim dhe hulumtim për të gjitha degët kirurgjike dhe do të trajtojë çështje të rëndësishme si diplomacia mjekësore dhe teknologjitë e avancuara. Qendra pritet të angazhojë profesionistë mjekësorë dhe



inxhinierë nga vendi dhe bota, me qëllim ofrimin e mundësive për bashkëpunim dhe zhvillimin e programeve të avancuara të trajnimit. Objektivat kryesorë të QKSTK-së përfshijnë krijimin e programeve gjithëpërfshirëse, përmirësimin e aftësive kërkimore dhe integrimin e


teknologjive të avancuara. Qendra do të shërbejë gjithashtu si platformë edhe për publikimet e Kolegjit të Kirurgëve të Kosovës dhe do të zhvillojë bashkëpunime me universitete dhe institucione ndërkombëtare. Përfshirja e laboratorëve të simulimit, programeve të

telemjekësisë dhe përgjithësisht një qasjeje multidisiplinare ndaj trajtimit të traumës dhe urgjencës, do të jetë thelbësore në punën e QKSTK-së. Në këtë kuadër, QKSTK-ja do të prodhojë edhe literaturë shkencore dhe do ta mbështesë diplomacinë mjekësore dhe shëndetin global. Drejtori i sapozgjedhur i Qendrës, prof. Latifi, theksoi se ajo do të jetë një institucion kryesor për arsimim, kërkim dhe avancim teknologjik në fushën e kirurgjisë, duke përfshirë mjekësinë kirurgjikale, traumën dhe urgjencën. Rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu, shprehu kënaqësinë e tij për emërimin e prof. Rifat Latifit në funksionin e drejtorit të QKSTK-së në UP. Prof. Hajrullahu theksoi se QKSTK-ja, si qendra e parë e

këtij lloji në rajonin e Ballkanit, do të ofrojë mundësi të reja për studentët dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe integrimin e teknologjive moderne për t'i avancuar standardet e kujdesit shëndetësor në Kosovë e përtej. Rektori shfaq bindjen se nën udhëheqjen e prof. Rifat Latifit, QKSTK-ja do të kontribuojë për zhvillimin e mjekësisë kirurgjikale dhe do ta inkurajojë kërkimin shkencor dhe inovacionin për t'i përballuar sfidat e ardhshme në fushën e shëndetësisë. Profesori Hajrullahu gjithashtu bëri thirrje për mbështetje nga institucionet e ndryshme për t'i realizuar qëllimet ambicioze të kësaj qendre, duke e vendosur Kosovën si lider në arsimin dhe shëndetin kirurgjik.

RIKTHEHET TRANSPORTI PUBLIK NË PRISHTINË PAS MË SHUMË SE NJË JAVE MUNGESË

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Autobusët e transportit publik e rifilluan punën të mërkurën në mëngjes në Prishtinë më shumë se një javë pasi i kishin lënë banorët e kryeqytetit të Kosovës pa transport publik si pasojë e një mosmarrëveshjeje mes komunës dhe qeverisë në detyrë. Trafiku Urban në Prishtinë njoftoi të martën vonë se do ta rifillonte punën dhe autobusët e tij u panë duke qarkulluar nëpër rrugët e kryeqytetit mëngjesin e së mërkurës. Në njoftimin e saj, Trafiku Urban theksoi se po rifillonte shërbimet pasi kishte nisur ndarja e mjeteve nga Ministria e Financave në detyrë dhe pagesa e faturave dhe borxheve nga komuna e Prishtinës ndaj tij dhe



transportuesve privatë. “Gjatë ditëve të fundit ndërprerja e transportit ka qenë e pashmangshme për shkak të pamundësisë financiare të krijuar nga mospagesa e detyrimeve të komunës ndaj ndërmarrjes”, ka njoftuar Trafiku

Urban. Në muajt e fundit, qeveria në detyrë dhe zyrtarët komunalë kanë shkëmbyer akuza të vazhdueshme ndaj njëri-tjetrit për gjendjen e ndërlikuar me financat në komunë. Transporti publik u rikthye pasi

Ministria e Financave në detyrë i ndau të martën 2.7 milionë euro për mallra dhe shërbime për komunën e Prishtinës disa ditë pasi komuna i miratoi të hyrat vetjake të vitit 2024 në vlerë prej 28 milionë euro. Ministri i Financave në detyrë, Hekuran Murati, tha të martën se kjo shumë ishte proceduar veçmas nga pjesa tjetër prej 25.9 milionë eurove e projekteve kapitale, “në mënyrë që të kryhet sot me prioritet, sepse kapitalet duke qenë në shumë linja marrin kohë më gjatë dhe nuk ishte e mundur të kryheshin sot”. Ai i arsyetoi vonesat në ndarjen e të hollave për komunën, pas kritikave të vazhdueshme nga kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama. “Vendimi i marrë nga

komuna e Prishtinës të enjten në mbrëmje për të hyrat vetjake, sipas legjislacionit në fuqi, fillimisht duhej ta kalonte verifikimin e ligjshmërisë, proces ky që bëhet nga ana e MAPL-së”, tha Murati. Murati shtoi se “është për keqardhje sjellja e deklaratat dezinformuese nga ana e komunës së Prishtinës që gjoja ministria nuk po bën alokimin e mjeteve kur, në fakt, edhe ata vetë e dinë që kemi të bëjmë me procedura që nuk mund të tejkalohen”. Mosmarrëveshjet mes komunës dhe qeverisë në detyrë i detyruan qytetarët e kryeqytetit gjatë gjithë javës së kaluar dhe fillimit të kësaj jave të shikonin për alternativa për të udhëtuar.

Kosova dhe Bosnja flasin për bashkëpunim ushtarak

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Ministri në detyrë i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Ejup Maqedonci, ka zhvilluar një takim bilateral me ministrin e Mbrojtjes së Bosnjës dhe Hercegovinës, Zukan Helez, në kuadër të ministerialit ShBA -

Karta e Adriatikut (A5). Sipas njoftimit të Ministrisë së Mbrojtjes, gjatë takimit të dy ministrat kanë diskutuar për forcimin e marrëdhënieve dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive dhe forcave të armatosura.

Në komunikatë theksohet se ministrat shprehën gatishmërinë për t'i shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive dhe ushtrive, duke vlerësuar se ky bashkëpunim ndihmon në ndërtimin e partneriteteve të

qëndrueshme në rajon. Ministria, gjithashtu, thekson se bashkëpunimi rajonal mbetet një komponent thelbësor për garantimin e një mjedisi të sigurt, të qëndrueshëm për mirëqenien e qytetarëve dhe të vendit.



SPERTK i drejtohet Kuvendit: Siguroni financimin e pavarur për RTK-në

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Sindikata e Punëtorëve e RTK-së (SPERTK) i drejtohet legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës me kërkesën që të sigurojë më në fund financimin e pavarur dhe të qëndrueshëm për transmetuesin publik. Sipas një njoftimi për medie, thuhet se modelet e financimit ekzistojnë dhe miratimi i ligjit të ri për RTK-në është urgjent, po ashtu edhe ndërtimi i pronës së re të institucionit. "RTK prej 26 vitesh

funksionon në pasiguri të vazhdueshme. Në vitin 2021, nga buxheti i saj u shkëputën edhe 2.2 milionë euro, duke e lënë transmetuesin publik me financimin më të ulët në rajon. Kjo gjendje është e padrejtë për punëtorët dhe e dëmshme për shërbimin publik", thuhet në njoftim. "SPERTK kërkon që: Para miratimit të buxhetit nacional, për RTK-në të vendoset rritja 0.7% në përputhje me rritjen vjetore të buxhetit të shtetit. Të miratohet ligji

i ri që garanton financim të pavarur dhe funksionim normal të institucionit. Të fillojë procesi i ndërtimit të objektit të ri të RTK-së, i vonuar prej shumë vitesh", thuhet në njoftim. Ndër të tjera bëhet me dije SPERTK-u do t'i paraqesë legjislaturës së re dhe organeve të ardhshme drejtuese kërkesat për rritje pagash dhe avancim të kontratës kolektive. "Ne do të presim deri në formimin e plotë të Kuvendit, Bordit dhe

menaxhmentit. Nëse këto çështje - veçanërisht rritja e menjëhershme e pagave - nuk trajtohen, SPERTK do të nisë masat sindikale pa vonesë. Rikujtojmë se RTK aktualisht funksionon pa Bord, pa Drejtor të Përgjithshëm, pa Kryeredaktor dhe me shumë pozita të mbajtura nga ushtrues detyre. Për këtë arsye, është e domosdoshme që legjislatura e re dhe Bordi i ardhshëm të shqyrtojnë me kujdes çdo kontratë dhe çdo shpenzim të buxhetit të RTK-së".



Siç thuhet në njoftim, RTK është pasuri publike. "Stabiliteti i saj është interes i qytetarëve dhe detyrim i institucioneve. SPERTK do të vazhdojë t'i mbrojë punëtorët dhe të kërkojë kushte të drejta e të qëndrueshme për ta".

BQK-JA PËRMBYLL FUSHATËN "EKONOMIA PËR TË GJITHË..."

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), në kuadër të angazhimeve për edukim financiar dhe në përputhje me Planin Strategjik 2024-2028 për gjithëpërfshirje financiare, ka realizuar fushatën "Ekonomia për të gjithë - java e vetëdijesimit për qasje në financa për personat me aftësi të kufizuara". Fushata u organizua në bashkëpunim me Forumin Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe me mbështetje financiare nga Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE). Lansimi i fushatës u mbajt në Prishtinë, ku u theksua se përfshirja financiare mbetet një ndër objektivat kryesore të BQK-së, me fokus të veçantë në mbrojtjen e konsumatorit, edukimin financiar dhe qasjen e



barabartë në produkte e shërbime financiare. Pjesëmarrësit u njoftuan me nisma konkrete, si zbatimi i Llogarisë me Shërbime Bazike, e cila u ofrohet pa pagesë konsumatorëve të cenueshëm, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, u prezantua krijimi i Këndit të Edukimit në

Gjuhën e Shenjave, i cili përmban materiale informuese dhe edukative në format audiovizual dhe në gjuhën e shenjave. Ky kënd do të pasurohet në vazhdimësi me përmbajtje e materiale shtesë për edukim financiar. Fushata u vazhdua me aktivitete informuese dhe edukative për

personat me aftësi të kufizuara në Gjilan, Gjakovë, Prizren dhe Pejë. Përveç prezantimeve dhe materialeve audiovizuale, pjesëmarrësve iu shpërndanë edhe libra për edukim financiar të përgatitur në alfabetin Braille. Pjesëmarrja e lartë e qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe kontributi i tyre me ide, sugjerime dhe komente mbi sfidat dhe mundësitë në qasjen financiare e bën fushatën të vlerësohet e nevojshme dhe domethënëse. Përfaqësuesit e Forumit Kosovar të Personave me Aftësi të Kufizuara e cilësuan këtë nismë si shembullin e parë të këtij lloji në rajon dhe më gjerë, duke e konsideruar hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të qasjes financiare për këtë kategori. BQK-ja ka theksuar se mbetet e

përkushtuar ndaj avancimit të edukimit financiar gjithëpërfshirës dhe mbrojtjes së konsumatorit përmes përshtatjes së materialeve informuese, përmirësimit të kuadrin rregullativ dhe zhvillimit të shërbimeve digjitale. Duke e integruar mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm në mbikëqyrjen e sjelljes së tregut, BQK siguron qasje të barabartë, informim të qartë dhe shmangie të çdo forme diskriminimi. BQK-ja shpreh përkushtimin e saj për harmonizimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse me standardet e Bashkimit Evropian, duke e konsideruar gjithëpërfshirjen financiare si parakusht thelbësor për zhvillim të qëndrueshëm financiar dhe ekonomik, në përputhje me praktikatat më të mira evropiane.

DËSHTIMI I "ELEKTROSEVER"-IT NË VERI KUSHTON 42 MILIONË EURO, BE-JA REFUZON KOMPENSIMIN NDAJ KOSOVËS

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kosova duhet t'i llogarisë të humbura 42 milionë euro të paguar për mbulimin e kostos së rrymës në veri në periudhën tetor 2022-dhjetor 2023, kur "Elektrosever"-i dështoi ta përmbushte licencën. Përkundër fjalëve të dhëna atëkohë, se do të kërkojë forma financimi për ta mbuluar dëmin vetëm e vetëm që "Elektrosever"-it të mos i hiqet licenca, tash Bashkimi Evropian thotë se nuk ka bazë ligjore për një kompensim ndaj Kosovës. Me qëndrimin aktual të Bashkimit Evropian, Kosova duhet t'i llogarisë të humbura rreth 42 milionë euro që i pagoi për mbulimin e kostos së rrymës në veri si pasojë e dështimit "Elektrosever"-it për

ta përmbushur licencën në periudhën tetor 2022 - dhjetor 2023. Përkundër që ishte zotuar të gjejë mjete financiare për mbulimin e dëmeve vetëm që "Elektrosever"-it të mos i merrej licenca pas shkeljes të afateve, blloku 27-anëtarësh nuk dëgjon më për atë që Kosova e konsideron borxh ndaj saj. Këtë e konfirmon përgjigja e Shërbimit të Jashtëm të BE-së pas muajsh pritjeje. "Ne nuk shohim bazë ligjore për këtë. Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian, Sorensen, mbetet i gatshëm t'i adresojë shqetësimet e sjella nga palët në dialog gjatë takimeve të kryenegociatorëve", thuhet në përgjigjen e Bashkimit Evropian. Sipas një deklaratë, në mars



2024 nga zëvendëskryeministri, tani në detyrë, Besnik Bislimi, ish-përfaqësuesi i Posaçëm për Dialogun, Miroslav Lajčak, kishte kërkuar Zyra e Rregullatorit për Energji të mos ia tërhiqte licencën

"Elektrosever"-it përkundër dështimit për nisjen e faturimit. Në këmbim, sipas Bislimit, Lajçaku ishte zotuar të gjejë forma financimi nga BE-ja për ta kompensuar dëmin nga tetori 2022 kur, sipas licencës,

"Elektrosever"-i do të duhej ta niste faturimin ose t'i hiqej licenca. Por, kompania, bijë e ndërmarrjes publike elektroenergjetike të Serbisë, e licencuar në Kosovë në qershor 2022, nuk nisi faturimin deri në janar 2024. Dëmi buxhetor i shkakuar si pasojë e këtij dështimi të "Elektrosever"-it në këtë periudhë llogaritet të jetë rreth 42 milionë euro. Për zotimin e Lajçakut, në prill 2024 Bilsimi i kishte dërguar shkresë zyrtare BE-së. Në total, që nga përfundimi i luftës, si pasojë e mospagesës së energjisë elektrike nga banorët në katër komunat me shumicë serbe në veri, dëmi buxhetor llogaritet të jetë rreth 350 milionë euro. (Tv Dukagjini)

Rriten të hyrat e qeverisë

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare për periudhën TM3 2025. Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe. Gjithsej të hyrat e qeverisë së

përgjithshme në TM3 2025 ishin 927.2 milionë euro, ndërsa të hyrat në TM3 2024 ishin 818.7 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë: Tatimet në produkte (73,6 %); Tatimet rrjedhëse në të ardhura (14,1 %); Pagesat për prodhimin

jashtë tregut (shitjet) (3,8 %). Ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave. Gjithsej shpenzimet e qeverisë së përgjithshme në TM3 2025 ishin 826.6 milionë euro, ndërsa shpenzimet në TM3 2024 ishin 774.8 milionë

euro. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë: Kompensimi i punëtorëve (28,2 %); Kontributet sociale dhe përfitimet (25,9 %); Formimi i kapitalit bruto (13,7 %); Konsumi i ndërmjetëm (13,6 %), ndërsa pjesa e



mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategori të tjera të shpenzimeve.

RUSIA ‘E GATSHME’ PËR LUFTË ME EVROPËN

Rusia dhe SHBA-të nuk bënë përparim drejt një marrëveshjeje paqeje për Ukrainën gjatë bisedimeve të tyre, tha një ndihmës i lartë i Vladimir Putin, disa orë pasi presidenti rus lëshoi kërcënime se Rusia ishte gati për luftë me Evropën.

Në komentet për mediat ruse, ndihmësi i Kremlinit Yuri Ushakov tha se pas një takimi pesë-orësh me të dërguarin e Trump, Steve Witkoff, dhe dhëndrin e Trump, Jared Kushner, të dy palët nuk ishin “as më larg dhe as më afër zgjidhjes së krizës në Ukrainë. Ka shumë punë për t’u bërë”.

Ushakov e quajti takimin “jashtëzakonisht të dobishëm, konstruktiv dhe informues”, por megjithatë tha se të dy palët nuk kishin arritur në një marrëveshje për çështjet kryesore, duke përfshirë linjat e mundshme të kontrollit territorial në një marrëveshje të mundshme paqeje midis Rusisë dhe Ukrainës.

“Ne nuk diskutuam ... propozime specifike amerikane, por diskutuam thelbin e asaj që është përfshirë në këto dokumente amerikane”, tha Ushakov për planin e paqes të paraqitur nga pala amerikane.

“Ne mund të pajtoheshim me disa gjëra ... dhe presidenti gjithashtu nuk e fshehu qëndrimin tonë kritik dhe madje negativ ndaj një numri propozimesh”.

Disa aspekte të negociatave nuk do të zbuloheshin, tha Ushakov, dhe ai tregoi se një samit tjetër midis Trump dhe Putin nuk ishte i afërt.

Sekretari i shtetit i SHBA-ve, Marco Rubio, tha më vonë se u bë “disa përparim” në garancitë e sigurisë.

“Ajo që jemi përpjekur të bëjmë, dhe mendoj se kemi bërë disa përparime, është të kuptojmë se me çfarë mund të jetojnë ukrainasit që u jep atyre garanci sigurie për të ardhmen”, tha Rubio për Fox News. Ai shtoi se SHBA-të shpresonin se një kompromis do t’u lejonte atyre “jo vetëm të rindëtonin ekonominë e tyre, por të përparonin si vend”.

Vlerësimet relativisht pesimiste të diplomacisë së së martës në mbrëmje vijnë pas deklaratave hapëse luftarake nga Putini, ndërsa Witkoff dhe Kushner mbërritën për bisedime në Kremlin, në të cilat ai akuzoi fuqitë evropiane për sabotim të paqes në Ukrainë dhe se “kërkesat evropiane” për t’i dhënë fund luftës ishin “të papranueshme për Rusinë”.

“Evropa po e pengon administratën amerikane të arrijë paqe në Ukrainë”, tha Putin, duke shtuar: “Rusia nuk ka ndërmend të luftojë Evropën, por nëse Evropa fillon, ne jemi gati tani”.

Putin nuk sqaroi se cilat kërkesa evropiane i konsideroi të papranueshme.

“Ato janë në anën e luftës”, tha Putin për fuqitë evropiane.

Witkoff, në udhëtimin e tij të gjashtë në Moskë këtë vit, pritej t’i paraqiste Putinit një version të përditësuar të një propozimi amerikan për paqe të hartuar me kontributin e një zyrtari të lartë rus dhe të ripunuar për ta bërë atë më të pranueshëm për Kievin.

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, tha se po “priste sinjale” nga delegacioni amerikan pas takimit të tij me Putinin, në një raund intensiv diplomacie me anije që administrata Trump e ka pretenduar si shansi i saj më i mirë deri më tani për t’i dhënë fund luftës.

Por mbetet skepticizëm i konsiderueshëm se Rusia është e gatshme të pranojë çdo lëshim, në vend që të vazhdojë luftën dhe të presë një përqendrim të mëtejshëm të marrëdhënieve midis Shtëpisë së Bardhë të Trump dhe aleatëve të saj evropianë.

“Jam gati të marr të gjitha sinjalet dhe jam gati për një takim me Presidentin Trump”, postoi Zelensky në X.

“Gjithçka varet nga diskutimet e sotme”.

Disa media amerikane raportuan se Zelensky pritej të takohej me Witkoff dhe Kushner në Evropë pas takimit.

Një transmetim i shkurtër video nga Kremlini tregoi dy delegacionet e vogla të ulura në anët e kundërta të një tavoline ovale të bardhë, me Putinin të ulur pranë këshilltarëve të tij Kirill Dmitriev dhe Yuri Ushakov. Putin i pyeti Witkoff dhe Kushner për një turne të shkurtër në Moskë që kishin bërë para takimit, me Witkoff që e quajti atë një “qytet madhështor”. Transmetimi më pas u ndërpre.

Dy aleatët e Trump mbërritën në Moskë të martën, pasi u takuan me zyrtarë ukrainas në fundjavë në Florida për të diskutuar rishikimet e planit origjinal të paqes prej 28 pikash, i cili favorizonte në mënyrë dërmuese Moskën.

Zelensky, në një shtytje diplomatike për të mbledhur mbështetje midis kryeqyteteve evropiane që kanë mbështetur ndryshimet në planin origjinal, tha në Paris se versioni i përditësuar i propozimit “duket më mirë”, por theksoi se “nuk kishte mbaruar ende”.

Zelensky ka kundërshtuar në veçanti dispozitat në planin 28-pikësh që do të kërkonin që Ukraina të dorëzonte territorin në lindje që aktualisht kontrollon dhe të vendoste kufizime në madhësinë e ushtrisë së saj.

Ai gjithashtu ka kërkuar garanci



të qarta dhe të zbatueshme sigurie nga perëndimi për të parandaluar një pushtim të ardhshëm rus.

Putin, nga ana e tij, ka thënë se vetëm propozimi origjinal i SHBA-së mund të shërbejë si bazë për bisedime të mëtejshme, ndërsa deklaroi gjithashtu se kërkonte rishikime të rëndësishme.

Pavarësisht diplomacisë intensive të udhëtimit me anije në javët e fundit, e cila ka prodhuar disa rishikime të planit të paqes të SHBA-së, tejkalimi i hendekut mbetet i vështirë: kërkesat maksimaliste të Rusisë në fakt kërkojnë kapitullimin e Ukrainës.

Trump tha në fjalimin e tij në një mbledhje të kabinetit të martën se lufta në Ukrainë ishte një “rrëmujë” dhe jo një situatë e lehtë për t’u zgjidhur.

Komentet e Putinit duket se synonin të nxisnin një përçarje midis Uashingtonit dhe kryeqyteteve evropiane. Zyrtarët evropianë kanë pasur njëfarë suksesi në kundërshtimin e planit origjinal të SHBA-ve, megjithëse mbetet e paqartë se deri në çfarë mase Uashingtoni po i merr parasysht shqetësimet e tyre.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, më herët të martën tha se Putin dhe Witkoff do të diskutonin “mirëkuptimet” e arritura së fundmi midis Uashingtonit dhe Kievit, duke shtuar se Rusia mbetet e hapur për bisedime, por do të këmbëngulë në arritjen e qëllimeve të “operacionit të saj

special”.

Këto qëllime përbëjnë kërkesa gjithëpërfshirëse që do të dëmtonin rëndë sovranitetin e Ukrainës, duke përfshirë shkurtime të thella në forcat e saj të armatosura, një ndalim të ndihmës ushtarake perëndimore, kufizime të gjera mbi pavarësinë politike dhe dorëzimin e territorit të kontrolluar nga Ukraina në lindje të vendit.

Në prag të bisedimeve me delegacionin amerikan në Moskë, Putin pretendoi se forcat ruse kishin marrë kontrollin e qytetit strategjik të Pokrovskut në Ukrainë.

I veshur me uniforma ushtarake gjatë një vizite në një qendër komande të hënën në mbrëmje, presidenti rus përshëndeti atë që e quajti kapjen “e rëndësishme” të Pokrovskut, dikur një qendër e madhe logjistike për ushtrinë ukrainase, megjithëse zyrtarët ukrainas më vonë e kundërshtuan këtë pretendim.

Rusia ka kaluar më shumë se një vit duke u përpjekur të pushtojë qendrën e vijës së frontit, e cila shihet si një portë hyrëse për në Donetsk, dhe ka pësuar humbje të mëdha në këtë proces. Analistët dhe blogerët ushtarakë ukrainas kanë pranuar se Rusia tani mban pjesën më të madhe të Pokrovskut, me harta të fushëbetejave që tregojnë se forcat e saj janë kryesisht nën kontroll.

I inkurajuar nga përparimet e fundit në front, Putin ka treguar në javët e fundit se ushtria ruse

ishte e përgatitur të vazhdonte luftën nëse diplomacia do të dështonte, duke theksuar vazhdimisht se forcat e tij mbeteshin në ofensivë në fushën e betejës.

Udhëheqësi rus gjithashtu të martën kërcënoi me hakmarrje kundër porteve dhe anijeve të Ukrainës pasi Kievi në ditët e fundit goditi disa anije në të ashtuquajturën flotë hije të Rusisë në Detin e Zi.


Presidenti rus kërcënoi se Moska do të “shtonte sulmet në portet ukrainase dhe në çdo anije që hynte në to” në përgjigje të sulmeve ndaj tankerëve rusë, të cilat ai i përshkroi si “pirateri”.

Duke i bërë jehonë Kremlinit, media shtetërore ruse të martën mbajti një ton të sigurt para vizitës në SHBA. Komsomolskaya Pravda, e përshkruar shpesh si “gazeta e preferuar e Putinit”, shkroi se komentet e presidentit sugjerorin se “gjithnjë e më shumë territor ukrainas po vihet nën kontrollin tonë – dhe se herën tjetër kushtet e Rusisë mund të jenë më të ashpra”.

Gazeta nënkuptonte se Moska i shihte bisedimet e fundit SHBA-Ukrainë si një rrugë pa krye, duke pretenduar se Kievi po refuzonte të kapitullonte.

“SHBA-të janë përpjekur për herë të tretë në 10 ditët e fundit të ushtrojnë presion mbi Ukrainën, dhe Washingtoni ka dështuar përsëri”, shkroi ajo.

The Guardian



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Vojvoda me shifrat fantastike në Serinë A

Como, 3 dhjetor - Futbollisti i Kombëtares së Kosovës, Mërgim Vojvoda, i ka regjistruar 149 ndeshje në Serinë A të Italisë me fanellën e Torinos dhe Comos. Përkundër këtij numri të madh të ndeshjeve

kampionale, mbrojtësi i krahut nuk është ndëshkuar asnjëherë me karton të kuq dhe për këtë është lavdëruar nga e përditshmja italiane "Corriere dello Sport". Deri më tani në Serinë A, Vojvoda ka edhe 4 gola

të shënuar e 14 asistime përgjatë këtyre 149 paraqitjeve. Në fillim të këtij viti, ai iu bashkua Comos nga Torino, ekip për të cilin ka luajtur 127 ndeshje dhe ishte transferuar në verën e vitit 2020.

Gjithashtu, Vojvoda ka edhe 71 paraqitje për Kombëtaren e Kosovës, me të cilën ka debutuar në vitin 2017, kurse vetëm një herë është përjashtuar nga loja me karton të kuq.



EKIPET E SUPERLIGËS KALOJNË RRETHIN E PARË TË KUPËS SË KOSOVËS

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Nuk ka pasur befasi dhe rezultate të papritura në xhiron e parë të Kupës së Kosovës në futboll. Nga nëntë ndeshjet e zhvilluara të mërkurën, fitore kanë realizuar të gjitha skuadrat favorite nga Superliga përballë rivalëve kryesisht nga Liga e Parë. Llapi dhe Prishtina e Re kanë realizuar fitoret më të thella, duke e mposhtur Vjosën përkatësisht Lepencin me rezultat prej 4:1. Drita ka fituar në udhëtim te Besa Peja, 0-3, derisa lideri i Superligës, Ballkani, i është revanshuar Rilindjes për eliminimin e vitit të kaluar, me një fitore minimale prej 1-0.

Gjilani e ka kaluar Istogun 2:1, me njërin nga golat e realizuar nga Oltion Bilalli, i cili është rikthyer suksesshëm pas lëndimit të rëndë të pësuar vitin e kaluar.

REZULTATET E KUPËS SË KOSOVËS 1/16

Dukagjini 3:1 Ramiz Sadiku
Ballkani 1:0 Rilindja 1974
Drenica 1:0 Prizreni
Prishtina e Re 4:1 Lepenci
Gjilani 2:1 Istogu
Besa Peja 0:3 Drita
Llapi 4:1 Vjosa
Trepça 1:2 Malisheva
Ferizaj 2:0 Tefik Çanga



	VS		3-1
	VS		1-0
	VS		1-0
	VS		4-1
	VS		2-1
	VS		0-3
	VS		4-1
	VS		1-2
	VS		2-0

REAL MADRIDI PLANIFIKON TRANSFERIMIN E NICO WILLIAMSIT



MADRID, 3 DHJETOR - Asgjë të re nga "telenovela" Vinicius Junior - Real Madrid. Braziliani dhe drejtuesit e klubit madrilien nuk kanë arritur ende marrëveshjen për një rinovim të mundshëm të kontratës, duke shtuar gjithmonë e më shumë mundësitë për një largim të mundshëm të sulmuesit gjatë merkatos së ardhshme verore. Ndërkohë, mediet spanjolle zbulojnë se Real Madridi ka piketuar zëvendësuesin e mundshëm të Vinicius Junior, në rast largimi të brazilianit dhe është pikërisht Nico

Williams. Anësori spanjoll ishte shumë pranë transferimit te Barcelona gjatë verës së kaluar dhe kur të gjithë prisnin zyrtarizimin te katalanasit, ai zgjodhi të rinovonte me Athletic Bilbaon. Por, e ardhmja e 22-vjeçarit mund të ndryshojë këtë verë. Real Madridi është i gatshëm ta paguajë klauzolën e lirimit të Nico Williamsit që është 100 milionë euro. Sulmuesi anësor është gati ta bëjë hapin e madh në karrierë dhe Madridi mund të jetë destinacioni i tij i ri nga vera e ardhshme.


Lewandowski do të mbetet lojtar i lirë

Barcelonë, 3 dhjetor - Robert Lewandowski do të largohet nga Barcelona në fund të sezonit dhe do të mbetet lojtar i lirë. Pas disa sinjaleve nga klubi dhe raportimeve në medie, është konfirmuar se Barcelona nuk do të aktivizojë opsionin për ta zgatur kontratën me sulmuesin polak. Lewandowski

është bashkuar me Barcelonën në verën e vitit 2022 si zgjidhja për krizën sulmuese të klubit dhe si ylli i madh që erdhi nga Bayern Muncheni. Ai ka fituar titullin e La Ligës në sezonin e tij të parë, por gjatë këtyre viteve klubi ka nisur një proces ristrukturimi të skuadrës. Presioni financiar dhe nevoja

për t'i ulur shpenzimet e pagave e kanë shtyrë Barcelonën drejt opsioneve më të reja dhe më afatgjata në sulm. Sipas raporteve, bordi i klubit ka vlerësuar se Lewandowski nuk është më në një nivel që justifikon një pagë të lartë dhe një rinovim kontrate. "Barcelona nuk do ta zgjasë

kontratën e Robert Lewandowskit. Ai po largohet nga klubi", shkruan "The Athletic". Barcelona është duke orientuar sulmin drejt një stili më të shpejtë dhe dinamik, duke lënë hapësirë për lojtarët e rinj dhe duke planifikuar të paktën një përforcim të madh në afatin e verës.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “DIONI BAU IÇ” Sh.P.K. me seli në Gillogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812172948 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "DIONI BAU IÇ" D.O.O. od Glogovac, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812172948 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “DIONI BAU İÇ” L.L.C. with headquarters Glogoc, has come to the decision to quit its business: 812172948 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Galeria Studio” Sh. P. K. me seli në Lipjan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811882390 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Galeria Studio" D. O. O. od Ljipljan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811882390 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljiivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Galeria Studio” L. L. C. with headquarters Lipjan, has come to the decision to quit its business: 811882390 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook 

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "360 Jet Fuel Kosovo" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812051928.
- Artist Ahmetaj shpall te humbur lej e armës me numër serik T110218U05167.
- Hysni Hameli shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" në Mazdrek të Hasit.
- Egzon Makolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" Drenas.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

